

Nënshkruhet marrëveshja midis Qeverisë dhe Komuniteteve Fetare Tradicionale

- Për Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nënshkroi Kryepiskopi Anastas -

Qeveria Shqiptare ka firmosur një marrëveshje historike me Komunitetet Fetare Tradicionale në vend, me Komunitetin Mysliman, Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Komunitetin Mysliman Bektashi. Marrëveshja

mes Qeverisë Shqiptare dhe Vatikanit ishte firmosur më parë.

Në bazë të marrëveshjes, që është një detyrim kushtetues, shteti respekton pavarësinë e komuniteteve fetare për t'u organizuar dhe për të ushtruar veprimtarinë, si dhe

për të administruar pasurinë që zotërojnë, në bazë të parimeve, rregullave, traditave e statutit të tyre. Qeveria angazhohet t'i përjashtojë ato nga taksat dhe merr përsipër të përshpejtojë punën për rikthimin dhe kompensimin e pronave.

Për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, në datën 24 tetor, në hotel "Tirana Internacional" në kryeqytet, u zhvillua një ceremoni e posaçme nga Ministria e Kulturës, me pjesëmarrjen e Kryeministrit (vijon në faqen 2)



Komunitetet Fetare Tradicionale përbëjnë thesarin kulturor dhe shpirtëror të vendit

Në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes mbi "Rregullimin e lidhjeve të ndërsjella" midis Këshillit të Ministrave dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë përshëndeti edhe Fortlumluria e Tij, + Anastasi.

Kushtetuta e vitit 1998 e Republikës së Shqipërisë është një nga më të mirat e Ballkanit, veçanërisht për sa i takon lirisë fetare. Në nenin 10 të saj, parashikohet një marrëveshje zyrtare midis Qeverisë dhe Komuniteteve Fetare Tradicionale, meqenëse ato përbëjnë thesarin kulturor dhe shpirtëror të vendit. Megjithatë shteti është laik, ai e njeh faktin se komunitetet fetare kanë një rol të rëndësishëm në shoqëri dhe japin kontributin e tyre, jo vetëm në bashkekzistencën paqësore fetare, por edhe në një atmosferë të përgjithshme tolerance, mirëkuptimi, drejtësie dhe paqeje.

Prandaj ne përshëndesim me kënaqësi dhe gëzim nënshkrimin historik të sotëm të Marrëveshjes mbi "Rregullimin e lidhjeve të ndërsjella" midis

Qeverisë Shqiptare dhe Komuniteteve Fetare Tradicionale dhe do të donim të shprehnim në emër të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, mirënjohjen tonë për të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë ngjarje të shënuar. Para së gjithash, për Shkëlqesinë e Tij, Kryeministrin prof. dr. Sali Berisha, për Kryetarin e Komitetit Shtetëror të Feve, av. Rasim Hasanaj dhe për të gjithë ata që kanë punuar për finalizimin e kësaj marrëveshjeje.

Pas kësaj ngjarjeje historike të shënuar, komunitetet fetare, duke punuar në harmoni njëra me tjetrën, do të kenë më tepër mundësi për aktivitetet dhe iniciativat e tyre, me qëllim lartësimin e njerëzve nga ana shpirtërore, në mënyrë të veçantë të të rinjve, për të bërë një jetë ndershmerie, krijimtarije dhe solidariteti. Duke u shprehur në gjuhën e fesë, për një jetë besimi të Perëndia, dashurie për të afërmin dhe shprese për të ardhmen, duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut vendimtar për zhvillimin e Shqipërisë, për progresin e përgjithshëm shpirtëror dhe kulturor të shoqërisë shqiptare.

Nënshkruhet marrëveshja midis Qeverisë dhe Komuniteteve Fetare Tradicionale

(vijon nga faqja 1)

z. Sali Berisha, Kryepiskopit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumluturisë së Tij Anastasit, Kryetarit të Komunitetit Mysliman, z. Haxhi Selim Muça, Kryegjyshit të Kryegjyshit të Botërore të Bektashinjve, Haxhi Dede Reshat Bardhi dhe Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Imzot Rrok Mirdita. Në ceremoni ishin të ftuar edhe personalitete të tjera të politikës, të kulturës, të komuniteteve fetare, të përfaqësive diplomatike në vend si dhe përfaqësues të medias.

Nga Komuniteti Orthodhoks merrnin pjesë edhe Mitropoliti i Beratit, Hirësi Ignati, Mitropoliti i Gjirokastrës, Hirësi Dhimitri, Episkopi i Apollonisë, Hirësi Nikolla, Episkopi i Krujës, Hirësi Andoni, klerikë dhe besimtarë.

* * *

Pas hapjes nga Kryetari i Komitetit të Kulteve, z. Rasim Hasanaj, e morën fjalën drejtuesit e komuniteteve fetare tradicionale.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Haxhi Selim Muça tha: “Ky është një eveniment i rëndësishëm dhe i shumëpritur në fushën e zhvillimit fetar në vendin tonë. Ajo rregullon çështje të njohjes si dhe marrëdhënieve të bashkëpunimit midis

shtetit dhe komuniteteve fetare në të mirë të shoqërisë shqiptare...”.

Pastaj përshëndeti Kryepiskopi Anastas, fjalë e cila botohet në faqen e parë të “Ngjallja”.

Ndërsa Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Haxhi Dede Reshat Bardhi, në fjalën e tij tha: “Jam i lumtur, sepse 41 vjet më parë kur shteti i diktaturës së urryer u vërsul me kasma, lopata për të prishur teqetë, xhamitë, kishat, është e vështirë të sjellim ndër mend një ditë të tillë historike”.

Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Imzot Rrok Mirdita theksoi në fjalën përshëndetëse: “Uroj që kjo marrëveshje të mos jetë një akt simbolik, por një shprehje e qartë e vullnetit të përbashkët të komuniteteve fetare dhe shtetit shqiptar, jo vetëm për çështjet e natyrës ekonomike e tatimore, por për gjithçka çfarë është e nevojshme për ecurinë normale të veprimtarisë së tyre”.

* * *

Marrëveshja parashikon hartimin e një ligji specifik për financimin e bashkësive fetare nga shteti, duke u bazuar në përvojën evropiane për mbështetjen e veprimtarive të bashkësive fetare.

Kryetari i Komitetit të Kulteve, z. Rasim Hasanaj theksoi se në

Kushtetuta e Republikës, nenet për besimin fetar

Neni 10:

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.
2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.
3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare.
4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të gjithëve.
5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.
6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 24:

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.
2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

projektligjin për fenë që do të përgatitet do të gjejnë pasqyrim edhe problemet që do të kenë komunitetet dhe grupet e tjera fetare. “Kjo marrëveshje iu rikthen statusin komuniteteve fetare që e kishin humbur në vitin 1967. Në këtë marrëveshje parashikohet një ligj specifik për ndihmën financiare nga shteti ndaj komuniteteve fetare, duke u bazuar në standardet evropiane. Do doja të falënderoja klerikët, të cilët ruajnë traditat fetare të vendit dhe harmoninë mes tyre, e njohur tashmë edhe në botë” - nënvizoi z. Hasanaj.

Ndërkohë që kreu i qeverisë z. Sali Berisha, e vlerësoi marrëveshjen një dokument historik dhe u zotua për zbatimin e saj dhe për hartimin e një ligji për financimin e tyre. “Marrëveshja që ne sot firmosim me autoritetet më të larta fetare të vendit shënon një kapitull të ri në marrëdhëniet midis shtetit shqiptar dhe besimeve fetare në Shqipëri. Ndaj marrëveshja është një dokument historik

dhe dua t'ju garantoj ju udhëheqësve më të lartë të besimeve të mëdha të kombit se do të bëjë çdo përpjekje për zbatimin e saj, për jetësimin e saj në interesin më të mirë të vendit dhe kombit”, - tha Kryeministri.

Gjithashtu, ai u kërkoi ndjesë publike të gjitha përfaqësive të komuniteteve fetare në vend dhe të gjithë besimtarëve, që për dekada me radhë u privuan nga e drejta e besimit, duke u shprehur se: “Nuk mund të mos theksoj se kjo marrëveshje në vetvete mbart detyrimin madhor të këtij shteti për t'u paraqitur një ndjesë të thellë, një falje të gjithë atyre klerikëve shqiptarë, besimtarëve shqiptarë që për besimin te Zoti, tek e vërteta u flijuan, u sakrifkuan, por qëndruan të pampostur, pasuruan altarin e martirëve të këtij kombi, me vlera që ndrisin dhe do ndrisin përjetë” - theksoi Berisha.

Korresp. i gazetës
“Ngjallja”



Kisha Orthodhokse ndihmon me metoda bashkëkohore në mësimdhënie

- Seminar në Durrës me 16 arsimtarë kosovarë -

Rexhep Begaj u befasua nga mikpritja. Mësuesi i vjetër në moshë dhe me përvojë të gjatë në arsim, u shpreh se “Nuk e kisha menduar më parë këtë kohë që kaluam këtu në Shqipëri. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë na ka bërë një pritje të jashtëzakonshme. Por më shumë, dua të veçoj takimin me Kryepiskopin Anastas. Ai është një lider i mrekullueshëm dhe me të drejtë na tha se ne shqiptarët kemi jo vetëm tolerancë fetare, por edhe tolerancë vëllazërore”. Rexhepi ishte një nga pjesëmarrësit në një seminar, ideuar posaçërisht për t’u ardhur në ndihmë mësuesve kosovarë të komunës së Malishevës, me të cilët stafi i Zyrës së Fëmijëve të Kishës, ka nisur bashkëpunimin prej vitesh, përmes aktiviteteve me fëmijët që kryhen çdo verë. Këtë herë bashkëpunimi u përqendrua në një vend-takim tjetër...

Nga 14-16 nëntor, në një nga hotelet e bregdetit të bukur të Durrësit, 16 mësues të shkollave 9-vjeçare nga Malisheva dhe 15 pjesëtarë të stafit të veprimtarive që organizon Kisha jonë në Kosovë, morën pjesë në seminarin me karakter trajnues “Metodat bashkëkohore të mësimdhënies”. Lektore ishte Ann Braynt, mësuese ameri-



kane me 30 vjet përvojë dhe kualifikim të gjerë në arsim. Prej kohësh ishte menduar një takim i tillë dhe duket se u arrit qëllimi në formën më të mirë të mundshme, përmes një programi të pasur aktiviteteve dhe shkëmbimi njohurish.

Fjalën përshëndetëse të fillimit të seminarit, e mbajti Episkopi i Krujës, Hirësi Andoni, i cili shprehu dëshirën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme. Disa nga tematikat e trajnimit ishin rreth organizimi të mësimin në një klasë ku përdoren shumë shqisa, sepse në bazë të kërkimeve të fundit është parë se nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshme. Në klasë duhet të përdoren meto-

dat dëgjimore, vizuale dhe kinestetike. Përdorimi i hartave ose skicave në bazë të një funksioni logjik gjatë orës së mësimin janë mjete nëpërmjet të cilave mësimi mund të përmbajë të tri metodat e sipërmendura, kjo në mënyrë që nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive. “Kjo është një përpjekje nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë për të dhënë ndihmesën e saj në rritjen e nivelit të arsimimit në Kosovë. Pjesëmarrësit nuk janë vetëm mësues, por edhe miqtë tanë më të mirë, me të cilët kemi bashkëpunuar në Kosovë dhe është gëzim që jemi të gjithë bashkë në Shqipëri”, theksoi z. Hoppe.

Pas trajnimit, të dielën, pjesëma-

rrësit morën pjesë në Liturgjinë Hyjnore që u zhvillua në kishën “Ungjillëzimi i Hyjlindësës” në Tiranë dhe më pas drekuan në mjediset e Akademisë Theologjike, ku u pritën ngrohtësisht nga zv/drejtori Hirësi Nikolla, me të cilin patën një bashkëbisedim miqësor dhe vizituan ambientet e Manastirit dhe të Akademisë. Ditën e fundit të veprimtarisë, për miqtë nga Kosova u realizua një ekskursion në qytetin e lashtë të Krujës, në muzeun e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit. Pjesëmarrësit ndanë me njëri-tjetrit përshtypjet rreth kësaj përvoje të paharruar.

Ndihma dhe prania e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë në Kosovë ka qenë e vazhdueshme, që nga viti 1999 dhe ka ndjekur një traditë të pasur përgjatë këtyre viteve. Përmes kampeve me natyrë edukative dhe argëtuese me fëmijët e familjeve kosovare është realizuar një bashkëpunim i ngushtë në shkëmbimin e ideve dhe thellimin e miqësisë, e cila nisi gjatë kohës së luftës dhe rritet çdo vit. Ky aktivitet, i pari i realizuar në Shqipëri me arsimtarët kosovarë, shërbeu si një nxitje për të vijuar më tej bashkëpunimin dhe miqësinë me njëri-tjetrit.

Isidor Koti

Kambanore për Kishën e Delvinës

Nga Viktor Dai

Dikur kambana e saj dëgjohej deri në Sarandë. Komunizmi e zhdukuri atë si shumë objekte të tjera të kultit. Vetëm 12 vjet më parë, me ndihmën dhe mbështetjen e Kryepiskopit Anastas ajo u rindërtua. Ndërkohë që këtë të diel, për herë të parë është vendosur kambanorja, e shoqëruar kjo me një meshë të veçantë.

Në këtë kishë historike në lagjen Llakë, Mitropoliti i Gjirokastrës, Dhimitri, ka drejtuar meshën e të dielës dhe gjithë komuniteti i ardhur, edhe nga Saranda e Gjirokastra kanë ridëgjuar kambanat në të. Kambanorja e re ngrihet tani 22.5

Të krishterë e myslimanë marrin pjesë në ceremoninë e përrurimit të kambanores së Shën Marisë. Më 1967, në vendin e saj u ndërtuan varrezat e dëshmorëve. Kambanorja e re ngrihet tani 22.5 metra e lartë.

metra e lartë dhe në krye të saj janë tri kambana. Por në këtë ceremoni morën pjesë edhe mjaft qytetarë të besimit mysliman. Pas meshës, Mitropoliti ka bekuar kambanoren e re, në prani të qindra besimtarëve dhe qytetarëve, mes të cilëve ndodhej edhe kryetari i bashkisë së Delvinës, z. Dhurim Alimani.

Historia

Delvinjotët thonë se kisha e Shën Marisë është më e vjetra e 9 kishave që ka pasur Delvina. Ajo ngrihet në zemër të lagjes Llakë,

më tradicionalja e qytetit të njohur për qytetarinë 500-vjeçare. Besimtari Spiro Zaharo, studiues i pasionuar i lashtësisë së qytetit të vet, na thotë se ajo ka vetëm 12 vjet jetë, pasi është bërë e re nga themelet dhe është inaguruar më 1996. Spiro na tregon me dorë nga kodra përballë, ku tani ngrihen varrezat e dëshmorëve. “Ja, atje ishte kisha që dikur quhej e Panajasë, ndërtim i shekullit të 17-të”, - kujton Spiro Zaharo e Jorgo Papa, një piktor që Delvinën e vjetër e ka hedhur në telajo me teknikën e grafikës. Të dy delvinjotët kujtojnë atë që kanë

përjetuar kur kishën e dikurshme, të njohur në gjithë Jugun, e rrafshoi kazma komuniste më 1967. Lëvizja komuniste mbi fenë e nxori atë në themele dhe vetëm pas gati 30 vjetësh u zëvendësua ky objekt kulti, nga më të pasurit.

Financimi

Kisha e Shën Marisë u financua nga vetë Kryepiskopi Anastas, i cili jo vetëm e vlerësoi, por edhe nxiti projektimin dhe rindërtimin e saj nga e para. Ndërkaq, familja Cimi, nga më autoktonet në Delvinë, u kujdes dhe përballoi shpenzimet për ngritjen e altarit të kësaj kisha.

(s.g/GazetaShqiptare/BalkanWeb)

Noli dhe komunizmi

Nga Atë Artur Liolin

Kryekancelar

i Kishës Orthodhokse Autoqefale
Shqiptare në SHBA

Do dëshiroja të bëja disa komente rreth qëndrimit të Nolit ndaj komunizmit.

...Në periudhën kur Noli ishte kryeministër, Shqipëria ishte e rrethuar nga shtete fqinje monarkiste dhe aspak demokratike, siç e kuptojmë fjalën sot (d.m.th. Serbia, Greqia, si dhe Italia fashiste)... Edhe refuzimi i fuqive perëndimore në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë për të ndihmuar qeverinë e re noline të vitit 1924 në nevojat e saj ekonomike emergjente nuk i la Nolit shumë rrugëzgjidhje (Lidhja e Kombeve të asaj kohe ishte shndërruar në një organizatë "krejt pa dhëmbë" me refuzimin e Amerikës për të marrë pjesë në të, refleksi i frymës së izolimit ishte një vendim që e dëshpëroi shumë Presidentin Uillson dhe mbase shpejtoi sëmundjen e tij).

Njohja e Bashkimit Sovjetik më 1924 u bë nga Britania e Madhe, si dhe mjaft shtete të tjera perëndimore dhe jo vetëm nga qeveria shqiptare e Fan Nolit, duke e bërë vitin 1924 të njihet në historinë e Rusisë si "viti i njohjeve". Historianë e shkencëtarë të politikës shqiptare si Nikola Pano dhe Robert Austin gjithashtu kanë vërtetuar këto fakte. Interpretime dhe vlerësime të gabuara mbi njohjen e Bashkimit Sovjetik nga qeveria e Nolit janë bërë nga shumë mendimtarë e politikanë të tjerë. Vlen të përmendet mbajtja nga Noli e një fjalimi të gjatë vlerësues, si dhe ruajtja e një momenti heshtjeje në Parlamentin shqiptar në respekt të presidentit amerikan Udro Uillson që ndërroi jetë në atë vit. Sipas mendimit tim, Noli u përpoq të mbante një qëndrim balancues dhe realist midis shteteve të Lindjes dhe Perëndimit të asaj kohe. Qëllimi i vetëm madhor i Nolit ishte: Një Shqipëri e pavarur. Ai shpresonte që gjerat do të evoluonin bashkë me përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe arsimore të vendit. Mosmbajtja e

zgjedhjeve brenda 6 muajve të qeverisë demokratike është një problem serioz; megjithatë të gjithë jemi dëshmitarë që kjo nuk është punë e lehtë, mjaft të shikojmë problemet zgjedhore në Shqipërinë e sotme, shumë dekada më pas. Presionet ishin të mëdha dhe nuk kishte (siç kemi sot) organizata të fuqishme për të këshilluar apo parashikuar mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Zgjedhjet elektorale kërkonin kohë, dhe kohë Noli nuk kishte. A bëri Noli gabime? Sigurisht që po. Siç thotë edhe fjala e urtë popullore: "Kush ha bukë, do bëjë thërrime".



Është e vërtetë dhe domethënëse që Noli kishte mendime të majta politike, pasi shikonte se Shqipëria e asaj kohe kërkonte reforma të thella agrare për të kapërcyer kushtet e rënda të trashëguara nga e kaluara. Mendimet demokratike Noli i mësoi dhe kultivoi nga studimet në Harvard, si dhe nga përvoja e jetës së tij në shoqërinë amerikane. (Edhe si fetar, mund të themi se Noli do ishte me një mendje me klerikë të ndryshëm të çdo besimi që kërkuan ndryshime për të mirën e popujve të tyre më të varfër e të nevojshëm. Noli vetë jetonte tamm si murg i thjeshtë në kushte personale tepër të përlurur: vegjetarian gjatë jetës, pa veturë, në apartamentin modest dhe rrethuar me libra). Qëndrime të ndryshme të tij, që sot mund të shihen si të prirura ose krejt të së majtës marksiste, i bënë edhe shumë shtete të tjera të asaj kohe, sado të gabuara që ato ishin. Nuk duhet të foku-

sohemi në veprime të izoluara gjatë nxjerrjes së konkluzioneve historike, por gjërat duhen parë në një sfond më të gjerë. Një gjë është e vërtetë: Noli nuk ishte komunist. Këtë fakt e vërtetojnë shkencëtarë të historisë sonë më kompetentë se unë. Mund të themi se në fushën politike Noli mund quhet si social-demokrat, po të gjejmë një parti të krahasueshme evropiane...

Është interesant vlerësimi i vetë Nolit për rënien e qeverisë së tij të '24-s kur thotë: "Qeveria jonë nuk fitoi për këto arsye: premtuam reforma agrare që fermerët prisnin

Shenjtë" në Boston, për rikthimin e mbretit në Shqipëri për arsyen e thjeshtë: "Më mirë një Shqipëri monarkiste e pavarur, se një Shqipëri hiç fare".

Marrëdhëniet e Nolit me qeverinë e Enver Hoxhës kishin vetëm dy arsye kryesore: Ruajtjen e pavarësisë së shtetit shqiptar, mbrojtje për moscopëtimin e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në OKB që po formohej në Nju Jork. Premtimet e shumta të qeverisë së atëhershme për reforma progresive. Pasi Noli mësoi mbi egërsitë e rënda të regjimit komunist në Shqipëri, ai u distancua, gjë që duket qartë kur ai nuk pranoi të kthehej në Shqipëri, as për të marrë titujt e ofruar nga qeveria komuniste (patjetër për qëllime të errëta kompromentuese), as për hulumtime shkencore, as për hyrje në çështje të mjegulluara fetare. A kishte Noli mendime të lëkundura për ndonjë udhëtim të tillë në atdhe? Sigurisht që po. Si çdo shqiptar që e do vendin e tij, është e vështirë të ndahet dashuria për Shqipërinë me realitetin e qeverisë në pushtet. Qeveritë e dytë vijnë, por dashuria për atdheun nuk lëviz.

Mendësia politike e Nolit duhet parë në evoluim; përndryshe rrezikojmë të bartim opinione të pavërteta. Në fund, si mund ta ftonte senati i shtetit të Massachusetts (Boston) Nolin për të dhënë bekimin e hapjes së sesioneve të vitit 1963, nëse Noli do ishte "komunist"? Apo si mund ta ftonte Nolin "komunist" presidenti Lindon Xhonsen posaçërisht në Shtëpinë e Bardhë, në korrik 1964, për të bekuar në Uashington dhe për të dhënë fjalim me rastin e 400-vjetorit të Shekspir? Argumente ndryshe nuk pinë ujë.

22 shtator 2008

*Adresa e Kishës Orthodhokse Autoqefale
të Shqipërisë në Internet:*

www.orthodoxalbania.org

E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

KRESHMA - ILAÇ PËR SHPIRTIN

Parajsa, është kurora që përgatitet të fitojë çdo besimtar orthodhoks. Por a fitohet lehtë kjo? Jo, duhen shumë përpjekje.

“Atleti nuk e merr dot kurorën po të mos luajë sipas rregullave të caktuara”, thotë Shën Joan Gojarti. E pra, edhe ne patjetër duhet t’iu përmbahemi rregullave që ka caktuar Kisha jonë që të mund të fitojmë këtë kurorë. Dhe kur nuk zbaton rregullat, humbet. Këtë e ka treguar historia e njerëzimit qysh nga fillimi, madje edhe Adami me Evën duke mos iu përmbajtur rregullave, ranë.

Edhe pse nga Kisha është bërë një punë e kënaqshme për të vënë në pah të mirat e kreshmimit, përsëri të disa besimtarë nuk ekziston një mendim i qartë për të. Pa dyshim, që periudha ateiste që ne kaluam shkaktoi shumë plagë në trupin e Kishës, plagë që sa vinë e po shërohen. Disa mendojnë se kreshmë do të thotë të mbash një dietë të rreptë, duke mos ngrënë disa ushqime si mishin, djathin, vezën etj. Duke i dhënë përparësi këtij mendimi, lënë mënjanë kreshmën shpirtërore. Shën Joan Gojarti thotë: “Jo, kreshmë e vërtetë nuk është të largohesh vetëm nga disa gjellë, por së bashku me këto të heqësh dorë edhe nga ligësitë dhe nga mëkatet.”

Një pjesë tjetër kanë mendim të kundërt dhe i japin përparësi më tepër kreshmës shpirtërore dhe lënë mënjanë dhe nuk respektojnë kreshmën ushqimore. Por këto janë të lidhura aq ngushtë me njëra-tjetrën, sa që një nënvleftësim i njëres, kushdo qoftë ajo, do të prishë patjetër imazhin konkret të saj. Në letrën e Apostullit Jakov (2:10), thuhet: “Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat.” Pra, nuk mund të quhet kreshmë e

rregullt nëse nuk e zbatojmë atë me përpikmëri duke mos anashkaluar të dyja anët e saj.

Përveç këtyre dy mendimeve që theksuam më lart, në grupe besimtarësh të ndryshëm hasim praktika të tjera të gabuara. Ka që praktikojnë mbajtjen e Kreshmës së Madhe të Pashkëve vetëm javën e parë të saj, pra nga dita e fillimit deri në të kremten e mrekullisë së grurit të Shën Theodorit, kur marrin edhe kungatën e shenjtë. Që nga kjo ditë ata e ndërpresin kreshmën për ta filluar përsëri në Javën e Madhe përpara Pashkës. Një pjesë tjetër kreshmojnë vetëm Javën e Madhe dhe ditën e Pashkës ata kungohen dhe mendojnë se të mbajturit kreshmë vetëm këtë javë është e mjaftueshme. E njëjta praktikë ndiqet edhe në kreshmën e Krishtlindjeve. Këto praktika janë shumë të gabuara dhe është mirë të mundohemi që të largohemi dhe të fillojmë të zbatojmë ato rregulla që na cakton Kisha jonë.

Kreshmë duhet të mbajë çdo besimtar i pagëzuar dhe jo siç mendojnë disa se duhet të kreshmojnë vetëm klerikët dhe ata që punojnë në kishë. Kisha ka caktuar edhe periudhat në të cilat duhet të kreshmojmë dhe në shtypin e kishës jepet përherë informacion edhe për mënyrën e kreshmimit dhe për ushqimet që duhet të konsumojmë.

Çdo besimtar duhet të zbatojë me përpikmëri çdo porosi ose “dënim” që i jep atë i tij shpirtëror. Cili do të ishte ai njeri që nuk do të zbatonte me përpikmëri porositë e mjekut kur jeta e tij është në rrezik? Asnjë. E pra edhe ne le të zbatojmë këto rregulla, le të marrim këto ilaçe, të cilat do të na shërbejnë për të kuruar shpirtin tonë dhe do ta bëjnë atë të denjë për të trashëguar jetën e përjetshme. Shën Joan Gojarti thotë: “Kreshmët janë ilaç, po ilaçi sado i dobishëm që të jetë, shpesh nuk vlen krejt, nga mungesa e përvojës së atij që e përdor. Sepse, duhet që njeriu të dijë kohën e përdorimit, sasinë e nevojshme, gjendjen e trupit që do të marrë ilaçin, kushtet klimaterike, dietën që duhet të mbajë, stinën më të përshtatshme të vitit, e shumë të tjera, të cilat po të mos i ketë parasysh, ilaçi nuk sjell asnjë dobi”.

Ndaj duhet t’i zbatojmë këto rregulla, t’i përdorim këto ilaçe sipas recetës që na jep Kisha, se një marrje e gabuar dhe jo e përshtatshme sjell pasoja jo të mira për veten tonë aq më tepër kur këtu bëhet fjalë për diçka që vlen më tepër, për diçka shpirtërore. Dhe një anashkalim në zbatimin e kësaj recete, patjetër që nuk do të na lejojë të shkojmë atje ku edhe dëshirojmë, në Mbretërinë e Qiejve.

Atë Spiro Bulika

Kreshma e Krishtlindjeve

Më 15 nëntor filloi Kreshma e Krishtlindjeve dhe mbaron më 24 dhjetor. Në këtë kreshmë, deri më 17 dhjetor lejohet, me përjashtim të së mërkurës dhe së premtes, përdorimi i peshkut. Nga 18 deri 24 dhjetor lejohet vaji e vera, me përjashtim të së mërkurës dhe të premtes.

Nëse e kremtja e Hyrjes së Hyjli-ndëses në tempull (21 nëntor), bie të mërkurë ose të premte lejohet të hahet peshk.

Tregoje kreshmën me vepra

“Mban kreshmë? Tregoje me vepra. Çfarë veprash? Kur shikon ndonjë të varfër, ndihmoje. Kur shikon armikun tënd, të pajtohesh dhe të bëhesh mik me të, të mos shash, të mos shpifësh, të mos vjedhësh, të mos bësh ndonjë padrejtësi, të mos mbash nëpër gojë njerëzit etj. Me fjalë të tjera, nuk duhet të mbajë kreshmë vetëm goja, por edhe syri, edhe veshi, edhe këmbët dhe të gjitha pjesët e trupit tënd.

Le të mbajnë kreshmë duart duke mos u ndotur me vjedhje dhe grabitje.

Le të mbajnë kreshmë këmbët duke u larguar nga rruga që të çon nëpër qendra mëkatore dhe nëpër mbledhje imoralësh.


Le të mbajnë kreshmë sytë duke mos u hedhur në fytyra të bukura me qëllim satanik e shtazor, sepse do të ishte një gjë qesharake sikur gojën ta largosh nga gjellët, të cilat në fund të fundit nuk janë të këqija në vetvete, kurse syve t’u japësh leje të shohin gjëra që janë të ndaluara dhe që janë vetvetiu të liga.

Nuk ha mish? Mirë bën, por mos i lër sytë e tu të hanë imoralitet dhe paturpësi.

Le të mbajë kreshmë edhe veshi. Por kur mban kreshmë veshi? Kreshma e veshit është të mos dëgjojë e të mos pranojë as sharje, as shpifje, as qortime. Sepse Shkrimi i Shenjtë thotë: “Të mos pranojë të dëgjosh kallëzime dhe fjalë të liga”.

Le të mbajë kreshmë edhe goja, e goja mban kreshmë kur nuk nxjerr asnjë fjalë të keqe. Se me të vërtetë, çfarë dobie vjen kur nga njëra anë nuk hamë mish dhe peshk e ushqime të tjera kreshmore, e nga ana tjetër, kafshojmë dhe copëtojmë të afërmit tanë?

(Shën Joan Gojarti)



Manastiret e Mitropolisë së Hirshme të Gjirokastrës

- Dëshmi të pasurisë shpirtërore të historisë, por edhe për pronat që iu morën Kishës -

1. *Manastiri i Spilesë*, midis fshatrave Qesarat e Saraqinishtë të Lunxhit. Themeluar në shek. e 16-të. Ka një shpellë në një vend të rrezikshëm, brenda së cilës ndodhej një kishë e vogël e vjetër, ku hyhej me shumë vështirësi. Të ardhura 200 lira turke në vit. Festonte më 8 shtator.

2. *Manastiri i Kamenës*, midis Delvinës dhe fshatit Kakodhiq. Themeluar në shek. e 12-të. Të ardhura 300 lira Turqie në vit. Festonte më 15 gusht.

3. *Manastiri i Dhiurit*, mbi malin e fshatit Dhiuri të Delvinës, themeluar nga mesi i shekullit XV. Të ardhura vjetore 180 lira Turqie. Festonte më 15 gusht.

4. *Manastiri i Teologos*, pranë fshatit Carkovicë, rrethi i Delvinës. U themelua në shek. VII dhe u rindërtua më 1846. Të ardhura vjetore 200 lira Turqie.

5. *Manastiri i Shën Ilias*, midis Jergucatit, Dhrovjanit e Muzinës. Themeluar në shek. e 12-të. Të ardhura vjetore 400 lira Turqie. Festonte më 20 korrik. Ka pasur 800 hektarë tokë e luadhe.

6. *Manastiri i Dhrianos*, midis fshatrave Zervat e Dhrovjan. Ndërtuar për herë të parë në shek. VI pas Krishtit. Të ardhura vjetore 300 lira Turqie. Ka pasur 600 hektarë tokë e luadhe. Festonte më 15 gusht.

7. *Manastiri i Pepelit*, mbi kodrën e fshatit Pepel. Ishte manastir i vjetër, i rindërtuar më 1748 prej jeromonakut nga Dhiuri Filote. Të ardhura vjetore 500 lira Turqie. Pjesa më e madhe e të ardhurave sigurohej nga ndihmat vullnetare të besimtarëve të të gjithë dioqezës. Festonte ditën e Shën Trinisë që është pas Rrëshajëve.

8. *Manastiri i Koshovicës* në zonën e Dropullit është ndërtuar në shek. XVIII. Të ardhura vjetore 40 lira Turqie. Festonte më 15 gusht.

9. *Manastiri i Zonarëve apo i Kaqomenos*, afër fshatit Katuna të Dropullit. Është ndërtuar në vitin 1566. Të ardhura vjetore 100 lira Turqie.

Kjo është një listë e manastireve që kanë ekzistuar në Mitropolinë e Hirshme të Gjirokastrës gjer në vitin 1967, kur regjimi ateist-komunist i kohës me një ligj të posaçëm ndaloi çdo veprimtari fetare, konfiskoi gjithçka që ata kanë pasur me vlerë dhe u ndryshoi destinacionin duke ruajtur vetëm disa si monumente kulturore.

Kjo listë është përpiluar në bazë të një dokumenti të vitit 1911, i cili është botuar në shtypin e kohës dhe që kanë ekzistuar deri kohët e fundit.

Përveç emërimit të manastirit dhe të vendndodhjes së tij, dokumenti ka edhe të dhëna të tjera. Nga këto ne e quajtmë si të domosdoshme për njohje dhe studim të shënojme kohën e themelimit të manastirit dhe të ardhurat vjetore të tij, që janë në lira Turqie të kohës. Autori i dokumentit nuk dihet.

DH.B.



10. *Manastiri i Derviçanit* në Dropull. Është themeluar në fillim të shek. të 16-të. Të ardhura vjetore 100 lira Turqie. Festonte më 8 nëntor.

11. *Manastiri i Ravenës* mbi fshatin Kallogoranxi. Në fillim ishte ndërtuar mbi një tempull pagan në shek. VI. Më vonë është rindërtuar. Të ardhura vjetore 150 lira. Festonte më 15 gusht.

12. *Manastiri i Vanishtës* mbi fshatin Vanisht në Dropull. Është i kohës bizantine, Të ardhura vjetore 100 lira. Festonte më 25 mars.

13. *Manastiri i Dhuvjanit* në jug-perëndim të fshatit Dhuvjan. Është ndërtuar më 1089 pas Krishtit dhe është rindërtuar para 250 vjetësh, prej një igumeni nga Gadiqi. Të ardhura vjetore 180 lira. Festonte më 8 shtator.

14. *Manastiri i Frashtanit*, mbi një kodër të fshatit Frashtan. Është ndërtuar gjatë shek. të 6-të. Të

ardhura vjetore 30 lira. Festonte më 15 gusht.

15. *Manastiri i Cepos* afër fshatit Gradiq, nja 2 orë larg Gjirokastrës. Është themeluar së pari në kohën e perandorit të Bizantit Konstantin Pogonatit dhe i ripërtëritur prej Andronikut të mëshirueshëm. Të ardhura vjetore 250 lira. Për një periudhë ka qenë qendër e mitropolisë së Gjirokastrës. Festonte më 6 dhjetor, ditën e Shën Kollit.

16. *Manastiri i Hormovës*, në fshatin Hormovë të Tepelenës. Është ndërtuar në shek. e 17-të. Të ardhura vjetore 50 lira. Festonte më 6 dhjetor.

17. *Manastiri i Tërbuqit* në fshatin Tërbuq. U rindërtua më 1864. Të ardhura vjetore 100 lira. Festonte më 15 gusht.

18. *Manastiri i Erindit* në fshatin Erind. Është ndërtuar në shek. e 16-të. Të ardhura vjetore 40 lira. I ishte kushtuar Shën Thanasit.

19. *Manastiri i Gjatit* pranë fshatit Gjat. I përket periudhës bizantine. Të ardhura vjetore 20 lira. Festonte më 15 gusht.

20. *Manastiri i Nokovës* midis fshatrave Nokovë e Mingul në Lunxhëri. Është ngritur gjatë shekullit të 18-të. Të ardhura vjetore 80 lira. Festonte më 6 gusht.

21. *Manastiri i Stegopulit*, në veri të fshatit Stegopol të Lunxhërisë. Themeluar në shek e 6-të me kontributin e J. Nami Dragos nga Saraqinishta. Të ardhura vjetore 100 lira. Festonte më 20 korrik, ditën e Shën-Ilias.

22. *Manastiri i Nivanit*, midis fshatrave Nivan e Nderan në Zagori të Gjirokastrës. Është ndërtuar në shek. e 16-të. Të ardhura 100 lira. Festonte më 8 nëntor.

23. *Manastiri i Hoshtevës* në një pozicion të bukur të malit të fshatit Hoshtevë në Zagori. Është ndërtim i periudhës bizantine. Ka të shënuar vitin 999 pas Krishtit. Të ardhura vjetore 60 lira. Festonte më 6 gusht, ditën e Metamorfozës.

24. *Manastiri i Konckës* në fshatin anonim të Zagorisë. I është kushtuar Fjetjes së Shën Marisë të 15 gushtit. Të ardhura vjetore 40 lira.

25. *Manastiri i Zhejit*. Ndodhej në fshatin Zhej të Zagorisë. I ishte kushtuar Ipapandisë së Burimit Jetëdhënës. Të ardhura vjetore 50 lira.

26. *Manastiri i Poliçanit*. Afër fshatit Poliçan të Pogonit. Është themeluar në shek. e 14-të. Është metoq i një manastiri tjetër më të vjetër, i Shën Marisë së Brodecit. I është kushtuar Shën Thanasit. Të ardhura vjetore 50 lira.

27. *Manastiri i Çatistës*, gjysmë ore në perëndim të fshatit Çatistë të Pogonit. Është themeluar më 1619 pas Krishtit. Të ardhura vjetore 100 lira.

28. *Manastiri i Ajellastit* në Leshnicën e Sipërme të rrethit të Delvinës. Është themeluar në shek. e 17-të. Të ardhura vjetore 80 lira. I është kushtuar Ipapandisë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Patriarku Ekumenik mban një fjalim historik para Sinodit Romanokatolik

Në Sinodin e Kishës Katolike, i cili u mbledh në Vatikan, në Kapela Sistina, nga 5-26 tetor, për herë të parë në histori ishte ftuar dhe mori fjalën Patriarku Ekumenik Vartholomeu.

Patriarku ishte vendosur në të djathtë të asamblesë sinodale dhe u prezantua me shumë ngrohtësi nga Papa Benedikti XVI, i vendosur në të majtë të sallës, ku si sfond ishte afresku i famshëm i Gjyqit të Fundit i Mikelanxhelos.

Fjala e Tërëshenjtërisë së Tij Vartholomeut ishte e konceptuar në tri pjesë dhe kishte si bosht qendror se si “të dëgjohet dhe shprehet Fjala nëpërmjet Shkrimit”.

“Kisha e krishterë, është mbi të gjitha, një Kishë e shkrimeve. Metodat e interpretimit mund të ndryshojnë nga një Atë i Kishës tek tjetri, nga një shkollë tek tjetra dhe nga Lindja në Perëndim, por me gjithë këto, Shkrimi është marrë gjithmonë si një realitet i gjallë dhe jo



si një libër i vdekur”, tha Patriarku Ekumenik.

Së dyti, ai nënvizoi se si duhet të “të shikosh Fjalën e Perëndisë”, veçanërisht nëpërmjet “bukurisë së ikonave dhe të natyrës”. “Çdo penelatë e një ikonografi, si çdo fjalë e një përcaktimi teologjik, çdo notë muzikore e kënduar në psalmodinë dhe çdo gur i gdhendur i një kishëze të vogël apo i një katedraleje madhështore, të gjitha këto shprehin Fjalën

Hyjnore në krijimin, që lavdëron Perëndinë në çdo qenie njerëzore dhe në çdo gjallesë.”

Së treti, Patriarku Ekumenik shpjegoi se si “të preket e ndahet Fjala e Perëndisë, veçanërisht “nëpërmjet kungimit të Shenjtorëve dhe Mistereve të Jetës”.

“Fjala e Perëndisë ka mishërimin e saj të plotë në krijimin, dhe sidomos në Misterin e Eukaristisë së Shenjtë. Atje ku Fjala bëhet mish dhe na lejon jo vetëm ta dëgjojmë e shohim, por edhe ta prekim me vetë duart tona”,- tha ai.

Pas kësaj, Papa falënderoi Patriarkun Ekumenik dhe tha se: “Të dëgjosh fjalën e Perëndisë hap sytë edhe për realitetin e sotëm” dhe se pjesëtarët në Sinod “do t’i vazhdonin punimet të ndriçuar nga fjalët” e Patriarkut Ekumenik. Ai do të deklaronte ndër të tjera, se “Etërit tuaj, janë dhe Etërit tanë. Atëherë si mund të mos jemi vëllezër?!”

Këshilli Evropian i Drejtuesve Fetarë-Deklarata e Berlinit mbi Dialogun Ndërfetar

Viti 2008 është deklaruar si viti evropian i dialogut ndërfetar. Në Evropën pluraliste dialogu ndërmjet linjave ndarëse, qofshin ato kulturore, linguistike ose fetare, ka një rëndësi të madhe. Në mbarë Evropën çështjet që lidhen me identitetin janë në qendër të debatit dhe shpesh feja është në qendër të diskutimeve. Evropa dhe evropianët kanë qenë duke bashkëpunuar në vazhdimësi me pjesën tjetër të botës, duke përjetuar gëzimin dhe sfidat e komunikimit ndërmjet ndarjeve kulturore dhe fetare.

Shpeshherë feja është parë si pengesë për një bashkëjetesë paqësore dhe ndërlihdje shoqërore. Ndërkohë ne e dimë se disa nga sfidat më

urgjente të kohës sonë, si ndryshimet klimatike, varfëria, emigracioni, diskriminimi dhe terrorizmi mund të zgjidhen nëse bashkojmë burimet midis linjave tradicionale ndarëse.

Në datat 3 - 5 mars 2008, Këshilli Evropian i Drejtuesve Fetarë “Fetë për Paqen” u takua në Berlin, një qytet i cili simbolizon historinë e ndarjes në Evropë por edhe bashkimin dhe fillimet e reja. Si drejtues fetarë ne mbështesim iniciativat për dialogë të mëtejshëm në këtë kontinent. Në mënyrë që të zhvillojmë dialogë të pastër, të përgjegjshëm dhe të mirinformuar, në të gjitha nivelet e shoqërisë evropiane ne ofrojmë më poshtë Deklaratën e Berlinit mbi Dialogun Ndërfetar:


Njerëzit e besimeve të ndryshme duhet të jetojnë së bashku në paqe

(1) Feja është përhapur në Evropë

Krishterimi, Islami dhe Judaizmi janë pjesë e historisë evropiane. Sot tradita të tjera fetare kanë zënë gjithashtu një vend në kontinent. Në çdo qytet apo fshat të Evropës ndodhet të paktën një vend adhurimi: një kishë, një xhami ose një sinagogë. Për të siguruar një të ardhme harmonike dhe me prosperitet për Evropën, njerëzit e besimeve të ndryshme duhet të jetojnë së bashku në paqe.

(2) Dialogu ndërfetar nxjerr në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet tona

Ne pranojmë faktin se në dialogun ndërfetar njerëzit e të gjitha besimeve ndajnë të njëjtat përvoja e nevoja. Ne gjithashtu pranojmë se jemi të ndryshëm nga njëri-tjetri në shumë anë dhe do të jemi të tillë. Traditat e ndryshme fetare kanë formuar rregulla e skema të ndryshme shoqërore, të cilat ndonjëherë kundërshtojnë njëra-tjetrën. Një nga qëllimet e dialogut ndërfetar është të pakësojë perceptimet e gabuara



të ndryshimeve kulturore, ndërkohë që kuptojmë se diçka e partnerit të dialogut është e nevojshme të qëndrojnë e ndryshme ose e huaj për ne.

(3) Dialogu ndërfetar duhet të rrisë respektin për të drejtat e njeriut

Dialogu ndërfetar duhet të respektojë vlerat shoqërore që gjenden në gjithë traditat e mëdha fetare dhe që janë përfshirë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Zbatimi i të drejtave të njeriut nuk lë mënjanë shumëllojshmërinë e këndvështrimeve apo sistemeve etike dhe interpretimeve.

(4) Ftesa për dialog është e hapur

Sa më tepër ne ndryshojmë, aq më shumë kemi nevojë për dialog. Nuk është kushti i dialogut që të kemi një spektër të gjerë vlerash dhe idesh.

Vetëm në rast mosrespektimi të vlerave më elementare, siç është e drejta për të jetuar dhe e qeverisjes, duhet të përjashtohen njerëzit nga (vijon në faqen 8)

Deklarata e Berlinit mbi Dialogun Ndërfetar

(vijon nga faqja 7)

pjesëmarrja në dialog. Ndërsa ftesa është e hapur, gjithsecili duhet të zbatojë rregullat e vendosura brenda një situatë të caktuar dialogu. Gratë dhe të rinjtë kanë këndvështrime të rëndësishme dhe kontribut për të ofruar e duhet të dëgjohet zëri i tyre në dialogun ndërfetar.

(5) Dialogu ndërfetar është një mënyrë lidhjeje me besime të tjera dhe ka fuqi transformuese.

Dialogu ndërfetar përbën një mënyrë të veçantë të bashkëveprimit me të tjerët nëpërmjet të cilit, të gjithë që përfshihen në të mund të transformohen. Dialogu mbi çështjet e besimit dhe identitetit nuk ka të bëjë me negociatat, sepse ne nuk kërkojmë rënje dakord, nuk ka të bëjë me debatet, sepse nuk kërkojmë të fitojmë mbi të tjerët dhe është më tepër sesa një diskutim, sepse ne kontribuojmë jo vetëm me argumente logjike, por dhe me histori e përvoja personale e prekëse e në këtë mënyrë lidhemi ekzistencialisht me njëri-tjetrit.

(6) Dialogu ndërfetar bën të mundur integritetin e besimeve fetare.

Në dialog ne vijmë më pranë njëri-tjetrit pa qenë e nevojshme të bëhemi të ngjashëm. Të gjithë sa marrin pjesë në dialog ndërfetar, duhet ta bëjnë këtë me integritet të plotë në traditën e tyre fetare dhe pa rrezikuar atë që kanë më të dashur. Në dialogun ndërfetar ne nuk synojmë të krijojmë një besim të ri ose të përbashkët.

(7) Dialogu ndërfetar i trajton me ndershmëri marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit.

Marrëdhënia e pushtetit midis grupeve të ndryshme fetare është ndonjëherë josimetrike. Kjo mund të shkaktohet për shembull nga varfëria/pasuria, gjuha, gjinia ose numrat (pakicë/shumicë). Dialogu ndërfetar nuk duhet të përdoret për ta fshehur këtë raport. Në dialog faktet dhe përvojat e një fuqie të pabarabartë duhen përmendur dhe duhen gjetur mënyrat për t'u lënë hapësirë atyre të cilët luftojnë për t'u dëgjuar.

(8) Dialogu ndërfetar bën të mundur pjesëmarrjen në shoqëri.

Dialogu ndërfetar duhet të merret me një spektër të gjerë çështjesh. Është e rëndësishme të studiohen vlerat e përbashkëta dhe të adresohen qëllimet e njëjta, por nuk duhet të lëmë mënjanë çështje në të cilat ka mospërputhje idesh, pasiguri ose frikë ndaj tjetrit. Disa prirje bashkëkohore siç janë zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së re në biologji, në mjekësi dhe komunikim, si dhe ndryshimet në perceptimin e familjes lidhen ngushtë me çështjen e vlerave dhe identiteteve. Besimet nuk bien dakord në përgjigjet që u japin këtyre çështjeve, por duhet t'i diskutojnë ato me vizion e kurajë. Dialogu nuk shërben si mjet drejt një fundi të paracaktuar,

Këshilli Evropian i Drejtuesve Fetarë (ECRL) mbledh së bashku 30 drejtues kryesorë fetarë të besimeve historike në Evropë: Judaizëm, Krishterim dhe Islam, së bashku me Budistë, Hinduistë, Sikë dhe Zoroastrianë si pjesëmarrës aktivë. Informacion për kontaktin: www.rfp-europe.eu.

por është e rëndësishme që dialogu të karakterizohet nga mirëkuptimi i të dy palëve, respekti ndaj ndryshimeve, si dhe pjesëmarrja dhe vlerësimi i të gjithëve në shoqëri e në këtë mënyrë të forcojë lidhjet sociale.

(9) Dialogu ndërfetar sjell vepra të përbashkëta.

Kuptimi i saktë i dialogut ndërfetar përfshin edhe veprën e përbashkët (diapraksis). Dinjiteti i jetës njerëzore rreth të cilit janë përqendruar të gjitha besimet, sfidohet prej varfërisë, dhunës, abuzimit të gratë e fëmijët, diskriminimi i emigrantëve dhe ndryshimet dramatike në mjedisin natyror. Besimet e ndryshme studiojnë së bashku këto çështje, ndonëse etika jonë mund të bazohet në burime të ndryshme. Dialogu ndërfetar duhet të ketë si qëllim grumbullimin e burimeve të traditave të ndryshme fetare në mënyrë që t'u bëjë ballë sfidave me të cilat Evropa përballlet sot. Nëpërmjet veprimit të përbashkët ne mësojmë të kuptojmë më mirë veten tonë, njëri-tjetrit, dhe botën në të cilën jetojmë.

(10) Struktura e bashkëpunimit ndërfetar ndihmon në kohë krize.

Vazhdimisht besimi luan rolin e vet në situata konflikti. Strukturat e ndërtuarat dhe të besuara për dialogun ndërfetar janë një fuqi mjaft e madhe kur marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve keqësohen. Drejtuesit fetarë duhet të merren me keqësimin e rrezikshëm e të dhunshëm të besimit brenda komuniteteve të tyre.

(11) Njohuria dhe lidhjet e ngushta me një traditë motivon të kuptuarit ndërfetar.

Një dialog ndërfetar i hapur dhe i besueshëm përparon më tej prej një njohurie të sigurt të traditës fetare të dikujt, si edhe të asaj të të tjerëve. Kjo njohuri duhet transmetuar brenda një fryme paqeje dhe respekti për traditat e ndryshme. Shumë besime pohojnë të vërtetë të cilat nuk qëndrojnë për besimet e tjera. Por kjo nuk përbën më pengesë për dialog dhe pjesë-

marrje të plotë në shoqëri, në krahasim me të vërtetat e pohuara apo të nënkuptuara të ideologjive sekulare. Dialogu midis besimeve, kulturave dhe grupeve sociale konsiderohet shpesh si dialog midis pohimeve kundërshtuese të së vërtetës dhe pikëpamjeve botërore.

(12) Besimi zë një vend të natyrshëm edhe në sferën publike.

Besimi vazhdon të ketë një rol të rëndësishëm për të luajtur në jetën publike e me shumë besime të Evropës. Kjo vlen si për minoritetet, ashtu dhe për shumicën. Paraqitja publike e simboleve fetare ose festimi i festave fetare nuk duhet parë as si një fyerje ndaj besimeve të tjera, dhe as si një kërcënim për bashkimin social. Minoritetet fetare në Evropë nuk ndihen të fyer për shembull prej festave të Krishtlindjes ose të Pashkës në vendet ku kjo mbetet një traditë për sa kohë respektohet liria e tyre fetare.

(13) Drejtuesit fetarë, besimtarët dhe autoritetet ndajnë përgjegjësinë për dialogun ndërfetar.

Të bindur se dialogu ndërfetar është i rëndësishëm për një Evropë të përparuar dhe në paqe u bëjmë thirrje drejtuesve fetarë të të gjitha, traditave fetare, në çdo cep të Evropës, të bashkohen në dialog ndërfetar, të bazuar në parimet e paraqitura në këtë deklaratë. U bëjmë thirrje të gjithë besimtarëve në Evropë të marrin pjesë me besim e kurajë në dialogun më të rëndësishëm, në dialogun e jetës, në komunitetet e tyre lokale, në familjet dhe vendet e tyre të punës. U bëjmë thirrje autoriteteve në nivel lokal, kombëtar dhe evropian të bashkohen me komunitetet fetare, duke ruajtur respektin e të dy palëve për rolet e ndryshme të njëri-tjetrit, si edhe të krijojnë korniza brenda të cilave praktikatat fetare dhe dialogu ndërfetar, i bazuar në parimet e kësaj deklarate, të zhvillohen më tej dhe të ecin më përpara për të mirën e një bashkëjetese paqësore në Evropë.

**DËGJONI RADIO "NGJALLJA",
NË FM 88.5 Mhz.**

**Ajo transmeton 24 orë për ju programe shpirtërore,
kulturore, sociale, historike etj., muzikë kishtare,
popullore e klasike, si dhe shërbesat kishtare.**

Festohet dita e Kryeengjëjve

Në fshatin Bubullimë të rrethit Lushnjë 8 nëntori është një ditë feste. Të gjithë besimtarët ia kushtojnë mbrojtësve të tyre të patrup dhe kryesisht Kryeengjëllit Mihail, emrin e të cilit mban dhe kisha.

Në këtë ditë, çdo punë ndërpritet dhe është një ditë e veçantë lutjeje për të gjithë, për shëndet e mbarësi.

Fshati Bubullimë ndodhet 17 km në jug të qytetit të Lushnjës, i shtrirë në fushat në lindje të Manastirit të Ardenicës. Themelimin si fshat e ka patur rreth shekullit të XII-të. Në kohën e Perandorisë Osmane administrohej nga Berati dhe Elbasani. Sipas ndarjes që i bënin lumenjtë Devoll dhe Osum.

Në vitin 1777 vjen në Bubullimë Shën Kozmai dhe predikon hapjen e kishës së fshatit dhe të një shkollë (rrapi nën hijen e të cilit u bë predikimi ka ekzistuar deri në vitin 1986). Në vitin 1785 hapet kisha e parë në këtë fshat me emrin e Kryeengjëllit Mihail. Episkop i Beratit në këtë periudhë ka qenë Joasafi (plaku) nga ky fshat. Deri në këtë kohë shërbesat fetare kryheshin në kishën e Metamorfozës në

në Tiranë janë ekspozuar edhe dy ikona. Një e Shën Marisë me Krishtin dhe një e Shën Thanasit. Njëra mban për autor dinastinë Çetiri dhe tjetra anonim.

Gjatë kohës së diktaturës u shkatërrua gjithçka me vlerë, sidomos biblioteka e saj e pasur dhe regjistrat themeltarë. Është e pikturuar në vitin 1961 nga Theodhori Qendro nga Fieri. Mbas mbylljes ajo u përdor si magazinë dhe nuk pati asnjë përkujdesje për mirëmbajtjen e saj. Pikturat murale i rezistuan mirë kohës.

Kjo kishë është rikonstruktuar në vitin 1997 me bekim dhe kontribut të Kryepiskopit Anastas dhe tani meshohet rregullisht. Janë krijuar ambiente të mira për katekizëm dhe rininë.

Klerikët që kanë dalë nga ky fshat:

Nga fshati Bubullimë kanë dalë shumë klerikë, dhe midis tyre edhe tre episkopë, konkretisht:

1. Episkop Metodi, ka shërbyer në Mitropolinë e Beratit në vitet 1736-1751. Episkop është hirotonisur në vitin 1720. Është i biri i atë Jakovit. Mësimet i mori në Korfuz të Greqisë dhe emrin e parë e ka patur Marko.

2. Joasafi, nip i Episkop Metodit. Ka shërbyer në Berat në vitet 1752-1801 (I thoshin edhe Joasaf plaku). Emri i tij i parë ka qenë Joan.

Të dy këta episkopë janë varrosur në Manastirin e Ardenicës nga e majta dhe e djathta e derës që hynë në parakishë.

3. Episkop Joasafi i ri, nip i Episkop Joasaf Plakut. Emri i parë i tij ka qenë Jakov. Ka shërbyer në Mitropolinë e Beratit nga viti 1802-1855.

Priftërinjtë që kanë shërbyer në këtë kishë kanë qenë: atë Isaku, atë Marko, atë Avrami, atë Nikolla, atë Jakovi, atë Vasili, atë Eftimiu, atë Stefani i Ohrit, atë Joani, atë Kristoja, atë Ilia dhe i fundit deri më 1967 kur u mbyllën kishat ikonom stravorfor atë Kristo Papa, të cilit në mënyrë të dhunshme i heqin mjekrën dhe për një vit papa Kristoja nuk doli nga shtëpia, deri sa vdiq më 1968.

**Atë Gori Ndreko,
Bubullimë**



Syrum të Fierit dhe në kishën e Shën Marisë në Bishqethëm. Kisha ka qenë e pikturuar në vitin 1831, por në vitin 1927 kisha u zgjerua si ndërtesë dhe këto piktura nuk ekzistojnë. Nga kisha e vjetër ngeli ikonostasi dhe ikonat e tij, i cili gjatë kohës së diktaturës u çmontua. Një pjesë e tij gjendet e ekspozuar në muzeun e Lushnjës, pjesët e tjera nuk dihet se ku përfunduan. Gjithashtu në Galerinë e Arteve

Korrigjim

Në numrim e kaluar të gazetës, në faqen 12, në mesazhin drejtuar Episkopit Nikon, në paragrafin e fundit fjala të trisubstancshëm, të lexohet të trinishëm.

Duke shpresuar një fitore



Këtë vit, me bekimin e Fortlumenturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas, u bë i mundur realizimi i dëshirës së shumë të rinjve, për organizimin e kampionatit kombëtar të futbollit dhe volejbollit. Kjo e mbështetur edhe nga Zyra Diakonia Agapes, dhe Zyra Rinore të Kishës, në kuadër të projektit: “Të rinjtë, duke punuar së bashku për një të ardhme më të mirë”.

Për Kryepiskopatën e Tiranës, ky kampionat u zhvillua më 18 tetor 2008, në fushën sportive në mjediset e Manastirit të Shën Joan Vladimirit, në Elbasan. Aty morën pjesë grupe rinore nga Tirana, Durrësi, Elbasani dhe fshatrat përreth. Fitues u shpall grupi rinor “Bijtë e Dritës” i Elbasanit.

Edhe për Dioqezën e Beratit, me bekimin e Hirësi Ignatit, u zhvillua në datën 18 tetor, në fushën sportive të fshatit Bubullimë, kampionati i futbollit dhe volejbollit.

Qindra të rinj nga 10 grupe rinore, nga Bubullima, Këmishtaj, Verria, Vajkani, Shën Pjetri, Topoja etj., u drejtuan fillimisht në kishën e Kryeengjëllit Mihail, për ta filluar këtë ditë me një lutje. Ashtu si sporti mban gjallë trupin (e rinon atë), edhe lutja mban gjallë shpirtin, i cili është edhe më kryesori për njeriun. Dikë e shikoje duke qëndruar në lutje përballë një ikone, dikë duke bërë kryqin, dikë duke ndezur një qiri.

Pastaj të gjithë u grumbulluan në mjediset sportive, ku fillimisht iu fol të rinjve që të kenë një kujdes për njëritjetrin. Sepse nëpërmjet këtij aktiviteti rinor, për ne të krishterët nuk është qëllimi të fitojmë thjesht një trofe sportive, por të përpiqemi që nëpërmjet virtyteve të krishtera, të besimit, dashurisë, përlulesisë, durimit, faljes, shpresës, gjykimit etj., të fitojmë “Mbretërinë e Perëndisë”.

Pastaj u hodh shorti dhe filloi gara e gjatë sportive. Skuadra e fshatit Shën Pjetër fitoi kampionatin e volejbollit, kurse atë të futbollit e fitoi grupi rinor “Bijtë e Dritës” i fshatit Topojë, i enorisë Shën Pjetër.

Një javë më pas, më 25 tetor 2008, në fshatin Verri të Fierit, u zhvilluan ndeshjet finale të kampionatit kombëtar të futbollit dhe volejbollit për grupet rinore “Bijtë e Dritës”. Ndeshja finale në futboll ishte ajo e grupit rinor të Elbasanit me atë të grupit rinor të fshatit Topojë.


Fitues i kampionatit të futbollit doli grupi rinor “Bijtë e Dritës”, i fshatit Topojë i enorisë Shën Pjetër nga Dioqeza e Beratit.

Dhjak Niko Lushi

Arseni kapadok (10 nëntor)

Është oshënar i ri i shquar, i njohur zyrtarisht si shenjt më 1986. E bëri të njohur “nxënësi” i tij, jeronti i shenjtë Pais nga Mali i Shenjtë. Lindi rreth vitit 1840 në Farasa të Kapadokisë së bekuar, në mes të Turqisë, nga prindër të virtytshëm, Elefteri, mësues, dhe Varvara. Theodhori, siç quhej më parë, dhe vëllai i tij mbetën jetimë para kohe. Për ta kujdesej një grua nga fisi i tyre. Kur ishte i vogël, ndërsa po mbytej në një përrua, i shpëtoi jetën një kalorës që ngjante me monak. Pra dëshiroi t’i përkushtohej Perëndisë.

Kështu në moshën 26 - vjeçare, muskuloz, me gjuhë të huaja dhe tepër i shkolluar edhe në Izmir, shkoi në manastirin e afërm, në manastirin e lashtë të Flavianëve. U qeth monak Arseni, por për shkak të nevojave e dërguan si mësues në fshatin e tij pasi e hirotonisën dhjak. Në moshën 30 vjeç u bë arkimandrit dhe atë shpirtëror. Me mençurinë dhe mrekullitë e tij ruante grigjën



nga tinëzitë e turqve, kryesisht nga kusarët dhe nga misionarë heretikë. Nuk ishte koprrac. Ai ishte asketik, i urtë dhe dijetar “me dallueshmëri” dhe shquhej për aftësi didaktike. Dinte të urtësonte, i ndjeshëm në dashuri, që të mos lodhte kafshët, asnjëherë nuk hipi në to, edhe pse ecte më këmbë me ditë të tëra, për shembull, kur shkonte larg, në bregdet (rrugë që e bënte pesë herë) që të lundronte në tokën e Shenjtë.

“Jam murg”, thoshte, pra jetonte me mundime dhe nuk lejonte gratë që t’i shërbenin.

Shijoi zbulësia, u dëftua si krua i çudirave të mrekullueshme për të krishterët dhe myslimanët, si i barabartë me shenjtorët e mëdhenj! Në shenjë respekti e thërrisnin “haxhi-efendi” dhe meqenëse e adhuronin, bënte “marrëzi”, pra e konsideronin si shenjt, por edhe trillan njëkohësisht! Lutjet e tij i kërkonte edhe patriarku. Refuzonte herë pas here të bëhej episkop, u bë vetëm eksark i Varrit të Tërëshenjtë dhe zëvendës mitropolitan. Në rrëfime përpiquej të ngrinte sedrën dhe jo të ishte i rreptë.

Gjatë shkëmbimit të popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë, në vitin 1924 përfundoi në Korfuz, ku shpejt u sëmur dhe ndërroi jetë (10.11.1924). Zhvarrosja e lipsaneve të tij mrekullibërëse u bë në vitin 1958 dhe që nga viti 1970 ruhen në Manastirin e Hyjlindëses në Surotinë, afër Selanikut.

Grigori çudibërës (17 nëntor)

Është rrënja teologjike e “Etërve kapadokë”. I dha emrin e tij jetëshkruesit të tij, Grigorit të Nisës (10 janar) dhe Grigor Theologut (25 janar) dhe nëpërmjet tij shumë të tjerëve. Theodhori, siç quhej fillimisht, u lind rreth vitit 213 nga aristokratë idhujtarë. Kur ishte 14 vjeç i vdes i ati. Duke qenë i mençur dhe i vetëpërmbytur studioi për drejtësi në qytetin e tij Neocesari të Pontit lindor të Azisë së Vogël, në bregdetin e Detit të Zi, bashkë me vëllain e tij. Studioi dhe në Aleksandri, ku një prostitutë, e shtyrë nga të tjerë, u lodh më kot që të shpifte dhe ta tërhiqte. Madje në çastin kur ai, për ta hequr qafe, ia dha vetë asaj paratë që ia kishin premtuar, ajo u demonizua. Kur shenjt i shëroi, atëherë ajo pohoi intrigen. Të dy vëllezërit shoqëruan familjen e motrës së tyre në Qesari të Palestinës, ku u magjepsën nga theologu dhe filozofi Origjen, pra u pagëzuan dhe mësuan pranë atij (233-238). Pastaj shenjtori u bë eremit në vendlindjen e tij. Kryepiskopi i tyre e zgjodhi episkopin e parë të Neocesarisë plot me idhuj, por ai fshihej si i përlur. Prandaj ai e “përkushtoi” (duket se e hirotonisi nga larg!! fenomen unik). Atëherë u bind (240), dhe “të gjitha u bënë sipas ligjit”. Pas një lutejeje të tij vëzhgoi Perëndilindësen dhe Joan Theologun (26 shtator), i cili i sqaroi çështjen e Shën Triadhës. Një kujdestar i një tempulli pagan besoi, pasi hierarku lejoi dhe u kthyen demonët e dëbuar nga prania e tij dhe pasi lëvizti një kodër, çudira që ua kishte kërkuar ky pagan, që të bindej. Gjatë një tërmeti shkatërrues, qëndroi vetëm kisha. Thau një liqen, burim të mirash, që të mos vriteshin mes tyre dy vëllezër, trashëgimtarët e tij. Lumi që përmbyste dhe shkaktonte



katastrofa, u kufizua përgjithmonë atje ku nguli shkopin e tij, madje nxori dhe filiz! Lexonte zemrat dhe shikonte larg. Një hebre “i vdekur”, shtrej si i tillë, të cilin e “vajtonte” një patriot i tij që të mashtronin kryepiftin, vdiq me të vërtetë. Gjatë përndjekjes së vitit 250 u fsheh për pak kohë dhe përndjekësit e tij dështuan, sepse iu duk si pemë etj. Kur vdiq (270) në dioqezën e tij kishte vetëm 17 idhujtarë, ndërsa kur u hirotonis vetëm 17 të krishterë! S’kishte pasuri dhe u varros në një varr të huaj, siç kishte kërkuar. Dimë gjashtë shkrimet e tij.

Atë Justin

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, DHJETOR 2008

1 E Hënë † Pr. Naum. Filaret Përdëllimtari. Theokliti i Lakedhemonisë.

4 E Enjte † Dëshmg. Varvara. Osh. Joan Damaskini. Hierod. Serafimi.

5 E Premte * Osh. Sava i Shenjtë. Dësh. Diogjeni. Osh. Noni.

6 E Shtunë † Nikolla i Mirës së Likisë. Dësh. Niseri. Dësh. i ri Nikolla.

7 E DIEL † **10 LLUKAIT.** Ambrozi i Milanos. Osh. Grigori në Athos.

12 E Premte † * Spiridhoni i Trimithundës. Hermani i Alaskës.

13 E shtunë † Dësh. Efstrati, Afksenti, Oresti, Evgjeni etj. Dëshg. Luçia.

14 E DIEL † **11 LLUKAIT.** E Paraetërve të Zotit Krisht. Dësh. Ariani.

15 E Hënë † Hierod. Elefteri i Vlorës dhe Anthia. Oshd. Suzana.

17 E Mërkurë * Pr. Daniel e 3 djemtë. Dionisi i Egjinës.

20 E Shtunë † Ignat Hyjmbajtësi. Filogoni i Antiokisë. Joani në Kronshtad.

21 E DIEL † **PARA KRISHTLINDJES.** Dëshg. Juliana etj. (Bëhet efqeli.)

22 E Hënë † Dëshmg. Anastasia. Dësh. Krisogoni, Zoili, Theodhota.

23 E Martë † Osh. Naumi në Ohër. 10 dëshmorët e Kretës.

24 E Mërkurë † Dësh. Evgjenia e Filipi. Dësh. i ri Ahmeti. (Shërbesa e Orëve.)

25 E Enjte † **LINDJA TRUPORE E ZOTIT TONË JISU KRISHT.**

26 E Premte † Mbledhja e Hyjlind. Mari. Nikodhimi në Rumani. (Hahen të gjitha.)

27 E Shtunë † Kr/dhjak. Stefani, dësh. i I^{re}. Hierod. Maurici.

28 E DIEL † **PAS KRISHTLINDJES.** Josifi i Marisë. Pr. David.

Vlerat e përbashkëta - çelësi i paqes dhe prosperitetit

Përfaqësues të Kishave Orthodhokse, Islamit dhe Judaizmit, si dhe anëtarë të Parlamentit Evropian të grupit të Partive Popullore dhe atyre Demokratike, shqyrtuan së bashku potencialin e feve dhe të dialogut ndërfeetar, për të zgjidhur konfliktet. Kjo u bë në sesionin e IX-të të Konferencës Orthodhokse për Dialogun, që u mbajt nga 16-17 tetor, në Jashi të Rumanisë. Konferenca u hap me përshëndetjen e Patriarkut Ekumenik dhe fjalën e mirëseardhjes së Patriarkut Daniel të Rumanisë, për të vazhduar me diskutime të shumta.

Në këtë sesion u diskutua dhe për të ardhmen e këtij dialogu, si të mbahet paqja dhe prosperiteti në Evropë dhe se si vlerat e përbashkëta mund të përdoren si instrument pajtimi.

Në veprimtari merre pjesë edhe Kisha jonë.



Të thirrur shenjtore

Kisha orthodhokse nuk fabrikon shenjtore. Shenjtëria është qëllimi, drejtimi, kuptimi i jetës së krishterë. I krishteri jeton në Kishë, e cila është e shenjtë. Ai është i vafshur me miron e shenjtë dhe ka marrë vulën e Shpirtit të Shenjtë. I krishteri i përgjigjet thirrjes së Perëndisë, tashmë e formuluar në Dhiatën e Vjetër, në të cilën përsëritet katër herë: “Jini të shenjtë, sepse edhe unë jam i shenjtë” (Lv. 11, 44-45; 19, 1; 20, 7; 20, 26). Kjo thirrje është marrë edhe nga apostulli Petro në letrën e tij të parë: “Por siç është shenjt ai që ju thirri, kështu edhe ju bëhuni shenjtore në gjithë sjelljet tuaja” (1, 15). Për këtë thirrje e kishte fjalën shën Pavli kur i shkruan Kishës së Korinthit, “të shenjtëruar përmes Jisu Krishtit, të thirrur për të qenë të shenjtë” (1 Kor. 1, 2).

Në Kishën e hershme, në epokën e persekutimeve, ideali i jetës së krishterë realizohej me martirizimin. Në greqisht fjala *martis* do të thotë dëshmitar. Kështu edhe kuptimi i parë i fjalës martir nënkupton një të krishterë që pohon publikisht besën më Krishtin dhe që si pasojë keqtrajtohet me mënyra nga më mizoret. Martirët vuajtën, pësuan dhe u vranë për Krishtin, dhe shenjtëria e tyre ilustron me faktin se ata braktisën gjithçka për të dëshmuar Krishtin. Ata mishërojnë kështu thirrjen e Zotit në Ungjill: “Ai që do të më dëshmojë para njerëzve do ta dëshmojë para Atit tim në qiej.” Martirët janë të krishterët e parë të shenjtë dhe nuk është gabim të themi se Kisha prehet mbi ta. Që në shekujt e parë, Kisha

kremtonte kujtimin e martirëve të parë duke i përkujtuar ditën e martirizimit të tyre, të lindjes së tyre në qiell, duke kremtuar edhe Eukaristinë hyjnore mbi varret e tyre dhe gjithashtu duke shkruar emrat e tyre në listat e shenjtoreve.

Shumë burra e gra në kushte nga më të ndryshmet kanë gjetur shpëtimin. Prandaj edhe Kisha njihet kategori të ndryshe shenjtore. Por shenjtoret nuk janë vetëm modele, ata ndërmjetojnë dhe luten pa pushim për ne, dhe iu përgjigjen lutjeve tona duke kryer edhe mrekulli. Bashkimi në lutje i Kishës militante e asaj triumfale quhet “kungimi i shenjtoreve”.

Kështu, në lutjen e pandërprerë të shenjtoreve, Kisha dallon pas të Tërëshenjtës Mari dhe shën Joan Pagëzorit, grupe të ndryshme shenjtore. Fillimisht kemi shenjtoret profetë të cilët lajmëruan ardhjen e Krishtit dhe apostujt që predikuan Ungjillin në tërë dhenë. Kisha gjithashtu ka dhënë edhe emërtimin isapostuj, pra i barabartë me apostujt, që punuan në kohë të ndryshme si apostujt. Dhe është rasti i shën Kirilit e Metodit, që ungjillëzuan sllavët, shën Vladimiri që e bëri të krishterë Rusinë. Më pas vijne edhe martirët që dëshmuar Krishtin dhe hoqën shumë për të. Kisha ruan titullin “konfesor, ose omologjet” për të krishterët që dëshmuar Krishtin gjatë persekutimeve, por nuk u vranë, por duruan tortura. Megjithatë periudha më e madhe e persekutimeve përfundoi më 313,

Kisha njohu më vonë valë të tjera persekutimesh prandaj ka edhe martirë të tjerë pas shekullit të 4-t. Përgjithësisht termi “martir i ri” shënon martirët e epokës së pushtimit turk apo nën pushtetin komunist. Kisha nderon edhe murgjit e shenjtë edhe gratë e shenjta. Mes tyre disa mishëruan “marrëzinë më Krishtin”, për të cilën flet shën Pavli (1 Kor. 1, 18-25). I emërtojmë me termin “të marrë më Krishtin”. Kemi edhe Hierarkët e shenjtë, titull rezervuar për episkopët e shenjtë që nga shenjtëria e jetës së tyre, kanë shkëlqyer në predikimet, në shkrimet, në mësimet e tyre si shën Joan Gojarti, shën Grigor Theologu, ose edhe nga zelli baritor që kanë pasur si shën Nikolla, shën Joan Përdëllimtari. Pak më vonë shikojmë edhe priftërinj të martuar, të cilët shkëlqyen me anë të përkushtimit të tyre baritor, me mësimin dhe mëshirën e tyre si shën Joan i Kronshadit, shën Nikolla Planasi. Kisha jep edhe emërtimin “i drejtë” për patriarkët dhe disa personazhe të Dhiatës së Vjetër si Jovi i drejtë dhe laikët e shenjtë si shën Joakimi, shën Ana, shën Zakaria e shën Elisabeta. Kemi shenjtoret anargjendë, shumica e të cilëve ishin martirë si shën Pandeleimoni, shenjtoret Kozma e Damian, arabë e romanë, shën Joani e shën Kiri, të cilët shëronin falas njerëzit. Dhe sot nuk pushojnë së bëri mrekulli të tjera. Këta shenjtore mishëruan fjalët e Krishtit kur thotë: “Falas morët, falas jepni” (Mt. 10, 8). Termi çudibërës shënon shenjtoret

që kryejnë vazhdimisht mrekulli të shumta dhe mund ta marrin si hierarkët p.sh. Shën Nikolla, shën Nektari, murgjit e shenjtë si shën Sergji i Radonezhit, ose edhe martirët shën Gjergji, shën Dhimitri.

Nuk duhet të shikojmë asnjë lloj grade në këtë klasifikim, nuk ka ndonjë kategori që të jetë më i shenjtë se një tjetër. Këto grupe shprehin universalitetin e shenjtërisë - faktin se çdo njeri, burrë, grua është thirrur të jetë i shenjtë si dhe shumëllojshmërinë e shenjtërisë - faktin se ka shumë rrugë që të çojnë në shenjtëri. Të rrethuar nga një re e madhe dëshmitarësh (Heb. 12, 1), çdo i krishterë do të gjejë jo vetëm një model që i përshtatet më shumë, por do t'i lutet edhe një shenjtori që të mund ta drejtojë e të ndërmjetojë për të në situatën që ndodhet.

Përktheu E. P.

Nga Ark. Job. Getcha



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë

Tel: (04) 234 117, 235 095.

Fax: 232 109

Shtypur

në shtypshkronjën “Ngjallja”

2008 - Viti kushtuar Apostullit të Kombeve, Pavlit

Simpozium - pelegrinazh, kushtuar Apostullit të Kombeve, Pavlit

- Simpoziumi përveç pjesës së referimeve, u zhvendos në
gjurmët e Apostullit në Izmir, Efes, Rodos, Kretë -

Në kuadrin e vitit kushtuar Apostull Pavlit dhe në kuadrin e Takimit Historik të Primatëve Orthodoxë, që u mbledhën në Fanar, nga 11-17 tetor, u organizua edhe një Simpozium kushtuar Apostullit të Kombeve, i konceptuar edhe si një pelegrinazh në disa qytete të Azisë së Vogël dhe Greqisë, të cilat ishin vizituar nga Apostulli gjatë udhëtimeve të tij.

Komiteti akademik që drejtoi Simpoziumin kryesohet nga Kryepiskopi i Kishës Orthodoxe të Amerikës, Hirësia e Tij Dhimitri, dhe ai organizator nga Mitropoliti i Sasimës, Hirësia e Tij Genadi.

Studiues të njohur nga Kishat e ndryshme të Krishtera dhe drejtues institutësh akademike nga të gjitha anët e botës, paraqitën para pjesëmarrësve të lartë një larmi temash që kishin

të bënin me jetën dhe letrat e Apostullit të madh. Hapja u veprimtarisë u bë nga Patriarku Ekumenik Vartholomeu I.

Patriarku Ekumenik drejtoi simpoziumin i shoqëruar nga Patriarku i Aleksandrisë, Kryepiskopi i Qipros, Kryepiskopi i Athinës, Kryepiskopi i Shqipërisë, Kryepiskopi i Pragës dhe Sllovakisë, si dhe nga përfaqësues të shumtë të Kishave orthodoxe autoqefale dhe autonome.

Ndër folësit mund të përmendim Kryepiskopin e Amerikës, Dhimitrin (Shën Pavli si Apostull, bari dhe theolog), Episkopin Tom Wright të Durhamit (Eskatologjia tek Apostull Pavli), prof. Petros Vasiliadhis (Liria te Shën Pavli), prof. Kristos Vulgaris (Përmasa Kozmike e Shpëtimit me Krishtin), prof. Helmut Koster (Karizma e Shpirtit),

prof. Karl Donfried (Jeta më Krishtin), prof. Brian Daley (Pavli tek Etërit e Kishës), prof. Joanis Karavidopoulos (Pavli, si urë teologjike midis Lindjes dhe Perëndimit), Rev. Dr. Jacques Khalil (Episkopi në letrat pastorale të Pavlit), dhe prof. Turid Karlesen Seim (Raca dhe gjinia te Pavli).

90 pjesëmarrësit e Simpoziumit provuan mikpritjen e Patriarkanës Ekumenike kur udhëtuan në qytetet e Izmirit (Smirnit) dhe Efesit, Antalias dhe Pergamit, si dhe në Kretë e Rodos, ku Simpoziumi u mikprit ngrohët nga hierarkë e besimtarë të Kishave lokale.

Patriarku Ekumenik mbylli zyrtarisht veprimtarinë në kishën e njohur të Shën Titit, apostull, episkopi i parë i Kretës, i vendosur nga Shën Pavli.

Korresp. i gazetës
"Ngjallja"

Të ruani unitetin e Shpirtit me anë të lidhjes së pajtimit

Prandaj ul gjunjët e mi përpara Atit të Zotit tonë Jisu Krisht, prej të cilit quhet çdo Atësi në qiejt e mbi dhë,

Që t'ju japë juve sipas pasurisë së lavdisë së tij të forcoheni në fuqi me anë të Shpirtit të tij në njeriun e brendshëm;

Që të rrijë Krishti në zemrat tuaja me anë të besimit,

Që të rrënjohet e të themeloset në dashuri të mund të kuptoni bashkë me gjithë Shenjtorët ç'është gjerësia dhe gjatësia dhe thellësia e lartësia,

Edhe të njihni dashurinë e Krishtit, e cila kapërcen çdo dituri, që të mbusheni me tërë plotësinë e Perëndisë.

Edhe atij që sipas fuqisë që veprohet tek ne mund të bëjë shumë më tepër nga gjithë sa kërkojmë ose mendojmë,

Atij i qoftë lavdia në kishë me anë të Jisu Krishtit në gjithë brezat e jetës së jetëve. Amin.

Ju lutem pra juve unë i burgosuri në Zotin, të ecni denjësisht në thirrjen që u thirrët,

Me çdo përpjekje e butësi, me zemërgjerësi, duke duruar njëri-tjetrin me dashuri,

Duke u kujdesur të ruani unitetin e Shpirtit me anë të lidhjes së pajtimit.

Efes. 3:14-21; 4:1-3



Çast lutjeje në Efes.



Sesioni përmbyllës në kishën e Apostull Titos në Kretë.